

**PROJEKTI I ZBATIMIT TE
HEC-it "MARJAN-GURA E VESHEVE " MBI LUMIN
ÇEMERICE , QARKU KORÇE**

RAPORTI TEKNIK I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

Pergatitur nga :

"TAULANT" sh.p.k.
QKL, LN-7574-03-2014
Eksperte mjedisi:
Ditika Qatipi
Erjona Qatipi



Investitor:

"MARITUDA" sh.p.k



Bashkepunim me, "EBS" sh.p.k.
Ing.Hidroteknik Fahri MAHO
Msc.Ing.Mjedisi Nelisa HAXHI



Tiranë

PARATHENIE

Hartimi i raportit teknik te projektit te propozuar është kryer në bazë te :

VKM nr. 686. datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiave e të afateve përzhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore"



PERMBAJTJA

1) QËLLIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR5

2) PLANIMETRINË E VENDNDODHJES SË PROJEKTIT, KU TË PASQYROHEN NË HARTË TOPOGRAFIKE KUIJTË E SIPËRFAQES, TË SHOQËRUAR ME KOORDINATAT, SIPAS SISTEMIT KOORDINATIV GAUS KRUGE, FOTOGRAFI DHE TË DHËNA PËR PËRDORIMIN EKZISTUES TË SIPËRFAQES QË DO TË PËRDORET PËRKOHËSISHT APO PËRHERË NGA PROJEKTI, GJATË FAZËS SË NDËRTIMIT APO FUNKSIONIMIT TË VEPRIMTARISË.5

3) INFORMACION PËR QENDRAT E BANUARA, NË ZONËN KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR ME FOTOGRAFI DHE TË DHËNA PËR DISTANCËN E TYRE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT TË PROPOZUAR, SI DHE PËRCAKTIMIN E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE QË ADMINISTRON TERRITORIN KU PROPOZOHEM PROJEKTI.9

5) PËRSHKRIM E PROCESVEVE NDËRTIMORE DHETEKNOLOGJIKE, PËRFSHIRË KAPACITETET PRODHUESE /PËRPUNUESE, SASITË E LËNDËVE TË PARA DHE PRODUKTET PËRFUNDIMTARE TË PROJEKTIT.11

6) INFORMACIONIN PËR INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME PËR LIDHJEN ME RRJETIN ELEKTRIK, FURNIZIMIN ME UJË, SHKARKIMET E UJËRAVE TË NDOTURA DHE MBETJEVE, SI DHE INFORMACIONIN PËR RRUGËT EKZISTUESE TË AKSESIT APO NEVOJËN PËR HAPJE TË RRUGËVE TË REJA.17

7) PROGRAMI PËR NDËRTIMIN, KOHËZGJATJEN ENDËRTIMIT, KOHËZGJATJEN E PLANIFIKUAR PËR FUNKSIONIMIN E PROJEKTIT, KOHËN E MUNDSHME TË PËRFUNDIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT DHE, SIPAS RASTIT, EDHE FAZËN E PLANIFIKUAR TË REHABILITIMIT TË SIPËRFAQES, PAS MBARIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT.21

8) LËNDËT E PARA QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN DHE MËNYRA E SIGURIMIT TË TYRE (MATERIALE NDËRTIMI, UJË DHE ENERGJI).....24

9) INFORMACION PËR LIDHJET E MUNDSHME TË PROJEKTIT ME PROJEKTE TË TJERA EKZISTUESE PËRRETH/PRANË ZONËS SË PROJEKTIT.24


10) INFORMACION PËR ALTERNATIVAT E MARRA NËKONSIDERATË, PËR SA I TAKON PËRZGJEDHJES SË VENDNDODHJES SË PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISË QË DO TË PËRDORET.....24

11) TË DHËNA PËR PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, TË ENERGJISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE.25

12) AKTIVITETE TË TJERA QË MUND TË NEVOJITEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT, SI NDËRTIMI I KAMPEVE APO REZIDENCEVE ETJ.....25

13) INFORMACION PËR LEJET, AUTORIZIMET DHE LICENCAT E NEVOJSHME PËR PROJEKTIN, NË PËRPTHJE ME PËRCAKTIMET E BËRA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN / AUTORIZIMIN/ LICENCIMIN E PROJEKTIT.25

14) KOPJE TË LEJEVE, AUTORIZIMEVE DHE LICENCEVE QË DISPONON ZHVILLUESI PËR PROJEKTIN E PROPOZUAR, NË PËRPTHJE ME PËRCAKTIMET E BËRA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN / AUTORIZIMIN/ LICENCIMIN E PROJEKTIT.25



Lista e fotografive



Fotografi 1: Perdorimi ekzistues i siperfaqes qe do te perdoret nga projekti7
Fotografi 2 : Perdorimi ekzistues i siperfaqes qe do te perdoret nga projekti7
Fotografi 3: Perdorimi ekzistues i siperfaqes qe do te perdoret nga projekti8
Fotografi 4: Perdorimi ekzistues i siperfaqes qe do te perdoret nga projekti8
Fotografi 5: Pamje e grykes te vendndertimit te vepres se marrjes 12
Fotografi 6: Pamje e vendkalimit te kanalit te derivacionit..... 13
Fotografi 7: Pamje e vendndertimit te tubacionit te presionit 14
Fotografi 8: Pamje e vendndertimit te godines..... 15
Fotografi 9: Pamje e terrenit ku do te zgjatet rruga ekzistuese 18

Lista e figurave

Figura 1 : Planimetria e pergjithshme e vendosjes se projektit Hec MARJAN-GURA E VESHEVE6
Figura 2: Largesia e zones se projektit nga zona e banuar me e afert 10

Lista e tabelave

Tabela 1: Te dhena baze per rrethin e Korces9
Tabela 2: Volumet e germimeve per Hec MARJAN-GURA E VESHEVE20
Tabela 3: Tabela e volumeve dhe siperfaqeve te depozitimit te inerteve20
Tabela 4: Preventivi i rigjenerimit te mjedisit23



1) QËLLIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

Hidrocentrali "Marjan - Gura e Vesheve" parashikohet të shfrytëzojë rezervat ujore të Gures së Vesheve, degë e perroit të Cemerices, qarku Korçë. Hidrocentrali "Marjan - Gura e Vesheve" do të ketë fuqi të instaluar $P_{ins} = 700 \text{ kW}$ dhe prodhim mesatar $E = 1\,600\,000 \text{ kWh}$.

Gura e Vesheve është një burim i fuqishëm që buron nga malesia e Ostrovices në shpatin lindor të tij dhe ka trajtën e një masivi me shpatë të mprehtë si nga lindja dhe perëndimi. Në të mbizoterojnë lartësitë mbi 1450 m mbi nivelin e detit.

Bazuar nga studimet paraprake, pellgu duhet të shfrytëzohet nëpërmjet ndërtimit të 1 HEC-i i cili do të përbente një nga shkallet e lumit të Cemerices të cilat janë në fazën përfundimtare.

Projekti i hidrocentralit "Marjan-Gura e Vesheve" parashikon të shfrytëzojë rezervat ujore të këtyre burimeve, degë e lumit Cemerice, përkatësisht për veprën e marrjes nga kuota 1463.15 m m.n.d dhe deri në kuotën 1311 m m.n.d.

Fuqia e instaluar është 700kW dhe jep një prodhim vjetor energjie

E = 1,274,611 kW.


Një përshkrim i mirefilltë i kësaj zone do të na ndihmojë për të kuptuar rëndësinë e ndërtimit të këtij hidrocentrali.

Ndërtimi i hidrocentralit brenda kondicioneve tekniko-ekonomik-mjedisor për situatën që po kalon vendi ynë dhe rajoni është një nevojë imediate për zonën në vecanti dhe tërë vendin në përgjithësi.

2) PLANIMETRINË E VENDNDODHJES SË PROJEKTIT, KU TË PASQYROHEN NË HARTË TOPOGRAFIKE KUFIJTË E SIPËRFAQES, TË SHOQËRUAR ME KOORDINATAT, SIPAS SISTEMIT KOORDINATIV GAUS KRUGE, FOTOGRAFI DHE TË DHËNA PËR PËRDORIMIN EKZISTUES TË SIPËRFAQES QË DO TË PËRDORET PËRKOHËSISHT APO PËRHERË NGA PROJEKTI, GJATË FAZËS SË NDËRTIMIT APO FUNKSIONIMIT TË VEPRIMTARISË.

- *Sipërfaqja e zones së kërkuar.*

Sipërfaqja që do të zihet nga projekti : 768.753 m², afërsisht 800 m²






Figura 1 : Planimetria e pergjithshme e vendosjes se projektit Hec MARJAN-GURA E VESHEVE
(Bashkangjitur raportit eshte e vendosur ne format A3)

• *Kufijte e sipërfaqes se kerkuar*

Nga perfaqesuesi i shoqerise investitore eshte perzgjedhur rrjedha e ujit qe vjen nga Gura e Vesheve, dege e lumit te Cemerices. Siperfaqja ujembledhese siguron nje prurje llogaritese mesatare vjetore prej rreth 0.57 m³/sek.

Kjo zone fillon nga kurora e maleve te Ostrovices qe ndajne zonen e Oparit me ate te Skraparit.

Vendi i perzgjedhur i ndertimit te godines te hidrocentralit ndodhet ne krahun e djathte te rrjedhes dhe shfrytëzon nje rrenie neto prej 146 m. Nga vepra e marrjes uji kalon ne dekantues dhe basenin e presionit dhe mandej ne tubacionin e turbinave. Mbas daljes nga turbina uji bashkohet perseri me perroin dhe shkon ne vepren e marrjes te HEC Marjan egzistues ndertuar ne vitin 1970.

Vepra e marrjes e ketij hidrocentrali do te jete veper marese malore e tipit tiroleze ne krahun e djathte te rrjedhes. Mbas vepres te marrjes uji pasi kalon ne dekantues dhe ne basenin e presionit, nepermjet tubacionit te turbinave kalon ne Godinen e HEC "Marjan-Gura e Vesheve".





Foto : Perdorimi ekzistues i sipërfaqes që do të përdoret për kohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë.



Fotografi 1: Perdorimi ekzistues i sipërfaqes që do të përdoret nga projekti



Fotografi 2 : Perdorimi ekzistues i sipërfaqes që do të përdoret nga projekti





Fotografi 3: Perdorimi ekzistues i siperfaqes qe do te perdoret nga projekti



Fotografi 4: Perdorimi ekzistues i siperfaqes qe do te perdoret nga projekti

3)INFORMACION PËR QENDRAT E BANUARA, NË ZONËN KU PROPOZOHEM TË ZBATOHEM PROJEKTI, SHOQËRUAR ME FOTOGRAFI DHE TË DHËNA PËR DISTANCËN E TYRE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT TË PROPOZUAR, SI DHE PËRCAKTIMIN E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE QË ADMINISTRON TERRITORIN KU PROPOZOHEM PROJEKTI.

- *Njesia e qeverisjes vendore qe administrojnë zonën ku zhvillohet aktiviteti.*

Zona ku do zhvillohet projekti i perket ish Komunes Lekas ,Rrethit Korce ,Qarkut Korce .

Të dhëna bazë për rrethin e Korces	
Sipërfaqja:	2180 km ²
Banorë:	194,000 (sipas 2004)
Pozita gjeografike:	Ne juglindje te Shqiperise
Zonat banuese	Ne 2 bashki dhe 14 komuna

Tabela 1: Te dhena baze per rrethin e Korces

- *Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike te zones.*

Vendi i perzgjedhur per ndertimin e nenobjekteve te h/centralit ndodhet ne shtirjen e tij gjatesore pergjate luges te lumit te Cemerices ne afersi te fshatit Marjan e cila kufizon kete fshat me ate te Cemerices dhe me Tudas ,Lavdsar. Paralel me lumin e Cemerices ecen dhe rruga automobilistike e cila lidh fshatrat. Vepra e marrjes, baseni, tubacionet e turbinave dhe vete h/centrali nuk atakojne qendra te banuara, objekte sociale dhe aktivite te cfardo natyre me impakte reciproke.

Komuna Lekas ka rreth 250 shtepi me rreth 1000 banore, ku nje pjese e popullsisë jeton ne emigracion. Pjesa tjeter meret kryesisht me bujqesi, pemtari, bletari, blektori dhe pune te ndryshme te zejtarise si punime guri, shara per perpunim druri etj.

Ndertimi i h/centralit do te krijojë impakt pozitiv per komunitetin qofte ne mundesine e punesimit sezonal dhe te disa personave definitive, por edhe ne furnizimin me energji.



Hydrocentrale te tilla mund te punojne shume mire dhe ne kushtet e mikrosistemit duke u bere garanci energjitike per zonen perreth.




Figura 2: Largesia e zones se projektit nga zona e banuar me e afert

4)SKICAT DHE PLANIMETRITË E OBJEKTEVE DHE STRUKTURAVE TË PROJEKTIN, SI DHE MËNYRAT DHE METODAT QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE DHE STRUKTURAVE TË PROJEKTIT.

Skicat dhe planimetritet e objekteve te projektit dhe strukturave te projektit



(Jane vendosur bashkengjitur raportit)

Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit.

Pastrimi dhe pergatitia e sheshit

Asnje dru nuk do te pritet qe eshte jashte trasese se ndertimit te kanaleve dhe shtimit te tubacioneve te Hec Marjan -Gura e Vesheve.

Konflikti me perdorimin aktual te tokes si toke bujqesore



Nuk do te merret toke me qira per trasene e kanaleve dhe te tubacioneve, meqenese punimet do te jene kryesisht pergjate shpateve te maleve.

Shqetesime te ndryshme qe mund ti shkaktohen komuniteteve tokale

Te gjitha lejet duhet te merren nga autoritetet e komunitetit dhe nese perkohesisht preken sipërfaqe toke, ato pas perfundimit te punimeve duhet te kthehen ne gjendjen fillestare.

Vendosja e veprave hidroteknike dhe e godines se hidrocentralit.

Nderhyrjet ne toke, gjate hapjes se kanaleve dhe per shtrimin e tubacioneve te dergimit te ujit ne hidrocentral, pritet te sjellin shqetesime te ndryshme.

Gjeresia e trasese se kanalit te vepres qe do te hapet te jete minimale per te zvogluar demtimin e siperfaqes se tokes dhe te sasise se dherave te germuara.

Magazinimi dhe trajtimi i materialeve te rrezikshme

Duhet treguar kujdes per te evituar ndotjen e tokes dhe ujit nga pikimet dhe rrjedhjet e mundeshme te lubrifikanteve dhe solventeve qe do te perdoren gjate ndertimit te vepres. Nje plan emergjence duhet te pregatitet ne rast te rrjedhjeve te lubrifikanteve dhe solventeve.

5)PËRSHKRIM E PROCESIVE NDËRTIMORE DHETEKNOLOGJIKE, PËRFSHIRË KAPACITETET PRODHUESE /PËRPUNUESE, SASITË E LËNDËVE TË PARA DHE PRODUKTET PËRFUNDIMTARE TË PROJEKTIT.

Hidrocentrali do te kete keto nenobjekte:

- Vepra e marrjes.
- Dekantuesi.
- Baseni i presionit.
- Ndertesa e h/centralit.
- Tubacioni i presionit.
- Kanali i shkarkimit.

Ndertimi i vepres se marrjes se ujit


Per ndertimin e vepres te marrjes te ujit do te perdoret vepra marese e tipit malor tiroles kombinuar me veper marje tip xhep, me dalje te ujit ne krahun e djathte te rrjedhes duke siguruar nje prurje te mjaftueshme dhe te garantuar per pune normale te ketij hidrocentrali per gjate gjithë periudhes te vitit. Kuota e vepres te marrjes ne perrua do te jete 1463.15 m mbi nivelin e detit.



Fotografi 5: Pamje e grykes te vendndertimit te vepres se marrjes

Ndertimi i dekantuesit

Ky nenobjekt i vepres do te ndertohet menjehere mbas vepres se marrjes. Ne fund pajiset me veper shkarkimi fundore dhe lidhet menjehere me basenin e presionit.





Fotografi 6: Pamje e vendkalimit te kanalit te derivacionit

Ndertimi i basenit te presionit

Para hyrjes ne basenin e presionit, kjo nyje hidroteknike presupozon lidhjen e vepres se marrjes me tubacionin e turbinave dhe ben rakordimin e parametrave hidraulike te rrjedhjes ne turbinen e hidrocentralit.

Vepra do te ndertohet me materiale rrethanore per te ulur koston e prodhimit si dhe per arsyen se ato gjenden me shumice ne zone. Baseni do te kete te gjithe elementet e sherbimit dhe mirembajtjes te tij ne lidhje me shkarkimet e teperta si dhe ato te pastrimit periodik.

Lidhja do te behet ne pjesen fundore te vepres se marrjes.

Ndertimi i tubacionit te presionit

Kjo pjese e vepres hidroenergjitike do te zgjidhet permes ndertimit te nje tubacioni celiku me spesor 6-9 mm te cilet do te perballojne nje renie bruto prej 150 m ne nje terren te thyer deri sa te mberije ne godinen e hidrocentralit.






Fotografi 7: Pamje e vendndertimit te tubacionit te presionit

Ndertimi i godines se hidrocentralit

Godina e hidrocentralit do te vendoset ne kuoten 1311.00m mbi nivelin e detit dhe do te kete te gjithë aksesoret e nevojshem per funksionimin e nje vepre energjitike.

Faza e ndertimit te vepres hidroenergjitike do te shoqerohet me veprime te vecanta te meposhteme:

- Punime dheu te fshehura , germim themelesh, mbushje bazamenti themelesh, mbushje te vendeve bosh.
- Vendosje e skeletit metalik.
- Instalim sheshi industrial.
- Instalimi i konstruksioneve metalike.
- Mbulese-veshje anesore.
- Muratura.
- Shtrim sheshesh.
- Veshje murri.
- Bojatisje.
- Vendosje dyer-dritare.
- Vendosje strehesh.
- Sistemim dhe rrethim trualli.
- Instalim pajisjesh te nderteses (si agregatet hidroturbogjeneratore, panelet e komandimit, kabina transformacionit etj.)



- Organizimi i brendshem i vepres per funksionin kryesor dhe aksesoret per personelin e sherbimit magazinimin etj.

Ndertimi i kesaj pjese te vepres do te shfrytezoje keto cilesi:

- H/centrali do te vendoset ne krahun e djathte te rrjedhes ne nje vend te sheshte poshte shkembit.
- H/centrali do te shfrytezoje lartesine e rënies maksimale te mundshme.
- Ndertimi do te jete ne kembe te kodres dhe anash rrjedhes ne te djathte te saj.



Fotografi 8: Pamje e vendndertimit te godines

Pajisjet zjarrfikese.

Ndertesa do te jete e pajisur me nje sistem zjarrfikes per kategorite e zjarrit A, D, E. Do te instalohen ne ndertese:

- 1 cope shuares CO2.
- 2 cope shuares me pluhur.
- Sistem nderlidhje telefonie celulare.
- Fuci rere, kazma, lopate.

Gjithashtu ne godine do te jete e instaluar edhe sinjalistika e evakuimit ne rast zjarri e vendosur neper ambientet e godines.

Ndertimi i kanalit te shkarkimit

Ne vepren hidroenergjitike do te kete nje nivel shkarkimi qe do te jete ne dalje te hidrocentralit ku nepermjet nje kanali rreth 15 m te gjate do te derdhet ne vepren e marjes HEC Marjan egzistues.

• **Proceset teknologjike:**

Tipi i procesit qe do te kryhet ne kete veper energjitike eshte ai i sistemit hidrik per prodhimin e energjise elektrike. Sasia e lendes se pare (prurje uji) e llogaritur eshte $Q_{llog} = 0.57 \text{ m}^3/\text{s}$.

• **Ruajtja e prurjes ekologjike**

Cilesia ekologjike e burimit mund te mbahet duke ruajtur nje prurje minimale. Perrenjte nuk duhet te thahen apo te kene regjime fizike ndjeshmerisht te ndryshueshem me qellim qe te ruhen funksionet hidrologjike dhe ekologjike te rrjetit te drenimit te tyre. Kjo ceshtje mund te linde ne mendje kur planifikohet dhe menaxhohen burimet ujore, vecanerisht ne zonat gjysme te thata. Shkarkimet ekologjike te cilat marrin pjese si rezultat i shkarkimeve te ujembajtesit ne nje regjim natyror, mund te mbahen artificialisht nga menaxhimi i rezervuarit. Percaktimi dhe hartografia e prurjes ekologjike per zonat gjysme te thata konsiderohet te jete e nje rendesie superiore.

Skema parashikon lenien e nje sasia uji me rrjedhje te perhershme ne shtratin ekzistues per qellime ekologjike dhe kryesisht bujqesore.

Leshimi i Q ekologjike ka te beje jo vetem me ruajtjen e parametrave ekologjike te zones por edhe me zhvillimin e prodhimitarise primare si algat, te cilat nga ana e tyre perbejne ushqim kryesor per peshqit e vegjel.

Ne llogaritjen e prodhimit te energjise eshte marre ne konsiderate sasia e ujit ekologjik dhe ajo per bujqesine.

Prurje ekologjike kemi konsideruar ate qe zgjat 355 dite ne kurben e qendrueshmerise ne sasine $0.02 \text{ m}^3/\text{sek}$ (Referuar ligjit me poshte).

LIGJ Nr. 111/2012 PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE

Neni 39

Përdorimi i burimeve ujore

1. Përdorimi i burimeve ujore natyrore i nënshtrohet kontrollit administrativ nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore dhe inspektimit nga inspektorët që mbulojnë fushën e mjedisit.
2. Çdo përdorues i ujit është i detyruar që në rrjedhën natyrore të lejojë rrjedhjen minimale ekologjike, duke mos e përfshirë atë në sasinë e ujit që është i autorizuar të përdorë.
3. Sasia e rrjedhjes minimale ekologjike për çdo trup ujqor natyror përcaktohet sipas planeve të menaxhimit të baseneve dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, duke u bazuar në karakteristikat specifike dhe vlerat natyrore e ekologjike që ka baseni ujqor.
- 4. Pavarësisht nga sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355).**


Kapacitetet prodhuese /perpunuese

Ai do te perbehet nga 1 agregate me turbine tip Pelton dhe me kapacitet fuqi te instaluar $N=700 \text{ Kw}$ me nje prodhim vjetor te energjise **$E= 1,274,611 \text{ kW}$** .

Burime te tjera qe nevojiten per konsum jane vetem ato njerezore dhe makineri e paisje.

Sasite e lendeve te para

Sasia e lendes se pare (prurje uji) e matur eshte rreth $Q_{llog} = 0.57 \text{ m}^3/\text{s}$.



Produktet perfundimtare te projektit qe do te zhvillohet

Produkti perfundimtar i projektit eshte prodhimi vjetor i energjise qe ka vleren

E= 1,274,611 kW.

6) INFORMACIONIN PËR INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME PËR LIDHJEN ME RRJETIN ELEKTRIK, FURNIZIMIN ME UJË, SHKARKIMET E UJËRAVE TË NDOTURA DHE MBETJEVE, SI DHE INFORMACIONIN PËR RRUGËT EKZISTUESE TË AKSESIT APO NEVOJËN PËR HAPJE TË RRUGËVE TË REJA.

Infrastruktura e nevojshme per zbatimin e projektit

• ***Lidhja me rrjetin elektrik.***

- Nisur nga zhvillimi rjeteve elektrike dhe nga mundesia e ndertimit te hec-ve ne zone jane hartuar dy varjante per lidhjen e ketij Hidrocentrali me sistemin.
- Ne variantin e pare mendojme te lidhet me linjen e fiderit,ekzistues nga N/stacioni 35/10 kv, Rehove duke rekonstruktue linjen sipas llogaritjeve te bera me siper ne kete studim,
- Sipas varjantit qe propozojme, ne linjen elektrike ajrore egzistuese te fiderit te fshatrave, do behet nderimi i percjellsave te demtuar te kesaj linje. Do behet kontrolli i shtyllave egzistuese si dhe tirantimi i tyre ne shtyllat kendore si dhe nderimi i atyre te demtuara me shtylla te reja.
- Perfundimisht do duhet te perdoren keto materiale shtese per linjen e re qe do bejme ne dalje te HEC-it :
- 14 shtylla b.a 12 ml. te reja ndermjetese si edhe 2 shtylla ankerore(fundore)
- kompletin me izolatore dhe aksesoret e tjere per linje dyfishe.
- 696 ml linje me percjelles AC-50, 6 fije - per linjen e re (nga Heci deri tek linja egzistuese).
- Linja egzistuese me 3 fije me prcjelles AC-70, AC-50 dhe AC-25 dhe me shtylla betoni egzistuese 10 ml te larta .

• ***Furnizimi me uje.***

Furnizimi me uje te pijshem do merret nga perroi duke instaluar impiant pastrimi.

• ***Shkarkimin e ujrave te ndotur.***

Shkarkimi i ujrave te ndotur si jane ujcrat fekal do te realizohet ne gropa septike.

• ***Informacion per rruget egzistuese dhe nevojen e hapjes se rrugëve te reja***

(neqoftese do te hapen)



(Signature)

Rruget e nevojshme per ndertimin e hidrocentralit mund te klasifikohen ne dy katgori:

- Rruget e hyrjes per ne vendosjen e ndertesese se hidrocentralit.
- Rruget e hyrjes per tek veprat e tjera (baseni, tubacioni etj) te cilat do te sherbejne gjate ndertimit.

Zona aktualisht ka nje rrjet rrugor rural komunikimi midis qendrave te banuara te pa asfaltuar. Me drejtimin hyrje nga Voskopoja rruga eshte e paasfaltuar. Rrjeti rrugor i zones shtrihet deri ne fshatrat e thelle. Nje pjese e segmentit rrugor me rrugen eshte ne gjendje te mire, ndersa nje pjese kerkon riparime. Ekzistenca e linjave elektrike ne te gjitha fshatrat eshte favorizuese per faktin se do te perdorej per problemet e ndertim-montimit. Ekzistenca e rruges pa dyshim qe krijon lehtesi reale per transportin e materialeve te ndertimit si dhe futjen e makinerise se ndertimit dhe perfundimisht edhe te agregateve. Megjithate per ndertimin e HEC eshte parashikuar dhe preventivuar rruga e ndertimit dhe riparimet e nevojshme per rrugen egzistuese.



Fotografi 9: Pamje e terrenit ku do te zgjatet rruga ekzistuese

- ***Shkarkimi i mbetjeve.***

Gjate kryerjes se operacioneve te ndertimit do te kete krijim te mbetjeve inerte ne sasira te konsiderueshme si rezultat i punimeve te ndryshme.

Nje pjese e mire e volumeve te germimeve do te nevojiten per mbushjen serisht te kanaleve te tubacioneve me material te ngjeshur nga germimet. Pervec kanaleve te tubacionit te turbinave nje pjese e mire e volumeve nga germimet do te hidhen dhe do te ngjeshen ne muret anesore te

Volumi total i germimeve eshte 1153 m³. Nga keto dhera 70% e tyre do te shperndahen ne siperfaqe depozitimi me lartesi deri ne 3.5 m ndersa 30% e tyre do te perdoren per mbushje. Dherat do hidhen ne nje distance mbi 100-200 m larg shtratit te lumit si detyrim i **ligjit 111/2012**.

Nga llogaritjet del qe: $V_{tot} \times 30\% = 1153 \text{ m}^3 \times 0.30 = 345.6 \text{ m}^3$

Ndersa: $1153 \text{ m}^3 - 345.6 \text{ m}^3 = 807.4 \text{ m}^3$ do te hidhen ne **3 pozicione** te ndryshme te cilat tregohen ne hartën topografike bashkengjitur ketij relacioni me siperfaqe perkatesisht :

$S_1 = 71.42 \text{ m}^2$, $S_2 = 85.71 \text{ m}^2$, $S_3 = 73.54 \text{ m}^2$

Projekti parashikon sistemimin e inerteve duke i ndare ne siperfaqe dhe volume te tilla duke respektuar ligjin 111/2012” **Per Menaxhimin e Integruar te Burimeve Ujore**” i cili shprehet qe:

Në tokat, pronë private dhe shtetërore, përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet, detyrimisht, të lihet:

a) një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga këto brigje, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj. Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit;

b) një sipërfaqe toke e lirë për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit, me gjerësi nga 100 m deri në 200 m.

Siperfaqet per hedhjen e mbeturinave jane zgjedhur ne menyre te tille qe tu pergjigjet normave. Keto distanca variojne nga 150m deri ne 200 m., por edhe ne ato vende ku thyhet kjo distance nuk perben problem sespe keto vende jane gropa tektonike te cilat kane nevojte per mbushje.

Do te merren masa qe keto materiale nuk do te hidhen ne afersi te grykave te lumit gjë e cila ndalohet dhe me ligj po ne ato pjese ku lugina zgjerohet, ne zona te zhveshura pa bimesi dhe siperfaqet do te ngjeshen e sistemohen .

Mbas ngjeshjes, nivelimit siperfaqjae sheshit te hapësirave te krijuara nga germimet do te shkriferohet me krere dhe do te mbillet me fare bari (*liloliumosefarebaringa bimetarishtorete zones silloj trifolium*). Kjo bimesi duke qene me sistem rrenjore xhufkore dote luaj rolin e stabilizuesit biologjik te mases se dheut ne fazen e pare te riaftesimit te tokes dhe fillimin e zhvillimit te proceseve fillestare te formimit te struktures se tokes dhe raportet ajër- uje te aggregateve toksore dhe poreve.

Volumet e germimeve per Hec MARJAN -GURA E VESHEVE	
	Volumi (Njesia m ³)
Vepra e Marrjes	60
Dekantues + Basen Presioni	193.11
Tubacion Turbinash	738.9795
Godina e Centralit	161.04
Totali m³	1153

Tabela 2: Volumet e germimeve per Hec MARJAN-GURA E VESHEVE

Me poshte po japim tabelen e sipërfaqeve dhe volumeve qe do te zene inertet e shperndara gjate kaskades , ku pozicioni i tyre eshte teper i favorshem si nga ana e mjedisit te cilat jane zgjedhur te hidhen mbi tarraca te zhveshura nga bimesia dhe pa interes publik por edhe nga ana ekonomike sepse keto tarraca ndodhen afer veprave te HEC-it.

Tabela e volumeve dhe sipërfaqeve te depozitimit te inerteve per Hec MARJAN -GURA E VESHEVE				
		Sip(m ²)	Lartesi mes (m)	Volumi (m ³)
HEC"MARJAN -GURA E VESHEVE"	sip 1	71.42	3.5	250
	sip 2	85.71	3.5	300
	sip 3	73.54	3.5	257.4
Totali		230.67 m²	3.5	807.4 m³

Tabela 3: Tabela e volumeve dhe sipërfaqeve te depozitimit te inerteve

Sic shihet nga tabela permbledhese e volumit te germimeve kemi volume te konsiderueshme te cilat duhen menaxhuar duke pasur parasysh qe te mos preken kriteret e mjedisit perreth por njekohesisht te gjenden vende dhe pozicione sa me afer veprave per depozitimin e tyre sepse ne te kundert do te rritej kostoja e transportit te tyre dhe rrjedhimisht do te rritej dhe kostoja totale e vepres.

Duke i alternuar keto dy kushte, pozicioni i ndertimit dhe shtrirja e veprave te HEC-it na rezervon hapësira te gjera shume afer veprave .



7)PROGRAMI PËR NDËRTIMIN, KOHËZGJATJEN ENDËRTIMIT, KOHËZGJATJEN E PLANIFIKUAR PËR FUNKSIONIMIN E PROJEKTIT, KOHËN E MUNDSHME TË PËRFUNDIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT DHE, SIPAS RASTIT, EDHE FAZËN E PLANIFIKUAR TË REHABILITIMIT TË SIPËRFAQES, PAS MBARIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT.

Duke pasur parasysh gjendjen aktuale te projektit teknik, shfrytezimin e kemi konceptuar ne dy faza:

Faza e pare.

Pergatitjen e raportit te fizibilitetit, dhe marjen e koncensionit per shfrytezimin e burimit Gura e Vesheve , dege e lumit te Cemerices per Hec MARJAN -GURA E VESHEVE.

Faza e dyte.

Ndertimi i vepres hidroenegjitike, shfrytezimin e tij dhe prodhimin e energjise elektrike.

Bazuar ne kerkesen e vete subjektit, rezervave te shfrytezueshme, kapacitetit prodhues te HEC-it, prodhimi vjetor ne objekt eshte parashikuar **E= 1,274,611 kW.**

Organizimi

Objekti do te jete nen administrimin e kompanise "MARITUDA" shpk . Ai do te kete ne perberje drejtues teknike e mekanike. Ne HEC do te punohet me turne, dhe puna eshte teresisht e mekanizuar.

Grafiku i Punimeve : (Eshte vendosur bashkengjitur ketij raporti)



➤ **MASAT PËR RIGJENERIMIN DHE REHABILITIMIN E SIPËRFAQES GJATË DHE PAS SHFRYTËZIMIT**

1. Krijimi i sipërfaqes për mbjellje të reja e gjelberime.
2. Sistemimin e materialit të mbulesës dhe të sterileve që dalin gjatë ndertimit.
3. Mbjelljen e sipërfaqeve të reja me fidane pishë .
4. Mirëmbajtja e sipërfaqeve të mbjella.
5. Sistemimin e brigjeve anësore.
6. Mbjellje fidanesh të rinj.


Sipërfaqia totale e shesheve të ndertimit është 768.753 m². Nga këto sipërfaqe kemi:

- 1- Vepra e marrjes së një sipërfaqe ndertimi 40 m².
- 2- Dekantues + Basen Presioni zënë një sipërfaqe funksionale ndertimi prej 128.74 m².
- 3- Tubacioni i turbinave së një sipërfaqe funksionale ndertimi dhe operimi prej 492.653 m².
- 4- Godina e Centralit së një sipërfaqe funksionale ndertimi 107.36 m².

Sipërfaqet e mesiperme janë sipërfaqet e ndertimit dhe operimit të veprave të HEC Marjan -Gura e Vesheve , të cilat janë të përhershme dhe nuk mund të mbillen me pemë sepse janë sipërfaqe ku vendosen proceset teknologjike të HEC-it sic janë turbinat , tubacioni i turbinave, vepra marrje etj, të cilat janë të ndertuara me konstruksione betonarme ose konstruksione celiku.

Nga sipërfaqia e ndertimit dhe operimit prej do të dali një volume total germimesh për ndertimin e bazamentit të veprave prej 1153 m³ dhera.

Ne sipërfaqen që duhet të rehabilitohet përfshihen sipërfaqet e shesheve të depozitimit të mbetjeve të cilat i nxjerrim nga llogaritja : $70\% \times 1153 \text{ m}^3$ (Volumi total i germimeve) = 807.4 m³ / 3.5m (lartësia e depozitimit) = 230.67 m², ndersa pjesa tjetër që mbetet 30 % do të shërbejë për mbushjen e sipërfaqeve të kanaleve të tubacioneve të turbinave : $30\% \times 1153 \text{ m}^3 = 345.6 \text{ m}^3$ /1m = 345.6 m² . Pra : sipërfaqja e rehabilitimit është 230.67 m² kjo sipërfaqe do të përputhet me sipërfaqen që do të mbillet me pemë , ku sipas skemes së pyllëzimit të pishës 2x2 kemi : $230.67 \text{ m}^2 / 4 = 57.66$ pra afërsisht 58 fidane , ne po marrim 60 fidane . Procesi për sistemimin e tarracave dhe mbjedhjen e pemëve do të fillojë mbas përfundimit të ndertimit të vepres dhe do të zgjasi 1 vit.



Hapje gropash	60 copë x 100 lekë/copë	6000 lekë
Blerje fidanash, transport etj.	60 copë x 100 lekë/copë	6000 lekë
Mbjellje, plehërim	60 copë x 50 lekë/copë	3000 lekë
Totali i preventivit		1500 lekë

Tabela 4: Preventivi i rigjenerimit te mjedisit

- 1- Mbjelljen e siperfaqeve te shfrytezuara të shkalleve me bime e peme.
- 2- Sistemimi i sterileve.
- 3- Mirembajtjen e siperfaqeve te mbjella.
- 4- Sistemimin e skarpateve para e pas shfrytezimit.

1. Mbjelljen e siperfaqeve te shfrytezuara të shkalleve me bime e peme.

Duke qene se si pasoje e shfrytezimit do te krijohen gropa, kanale projekti parashikon qe te mbillen peme ne keto siperfaqe te lira sic u percaktua me siper .Pas hedhjes se ketyre materialeve te germimeve siperfaqja e zene do te mbillet me bar ,pa prishur dhe njetrajtshmerine natyrale te zones perreth.

Perkujdesja e firmes per zhvillimin e bimesise do te vazhdoje edhe mbas mbjelljes.

Sa me siper duhet te theksojme qe siperfaqet qe do te germohen per shkak te vendosjes se tubacioneve apo kanaleve jane zgjedhur ne menyre te tille per t'ju shmangur pyjeve dhe kullotave.

2. Sistemimi i sterileve

Sistemimi i mbetjeve teknologjike sic theksohet me siper do te behet ne sheshin qe do te krijohet ne fazen e ndertimit dhe me pas kur te filloje sistemimi i skarpateve do te merret e do te depozitohet ne ane te shtratit te vepres per te realizuar kijimin e shtresave vegjetale e mbjelljen e pemeve per mbrojtjen nga erozioni i metejshem.

3. Mirembajtja e siperfaqeve te mbjella

Ajo do te realizohet nga subjekti. Mund te ngrihen prita per te perforcuar mbrojtjen e pyjeve nga erozioni ne zonat rreth karrieres. Gjithashtu do te kujdeset per mbareshtimin e pemeve qe do te mbillen nga shoqeria. Per kullimin e ujrave qe do te grumbullohen ne sheshin e depozitimit te sterileve do te hapet nje kanal per drenimin e ujrave jashte sheshit te depozitimit .

4. Sistemimi i skarpateve para e pas shfrytezimit

Subjekti ka per detyre e do te realizoje sistemimin e mirembajtjen e skarpateve te shkalleve ku aktualisht ai eshte i shkaktuar nga ndertimi. Ato do te mbahen nen vezhgam gjate gjithe kohes se shfrytezimit e pas saj deri ne mbareshtimin e pyllit. Skarpatet do te mbushen me material steril, do te perforcohen me trugje e do te hidhen dhera te mbuleses mbi to. Mbase te jete lidhur toka do te filloje mbjellja e pemeve.

8) LËNDËT E PARA QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN DHE MËNYRA E SIGURIMIT TË TYRE (MATERIALE NDËRTIMI, UJË DHE ENERGJI)

Lenda e pare qe do perdoret per ndertimin e objektit te Hec-it "MARJAN-GURA E VESHEVE" jane:

- 1.Cakull ose zhavorr lumi.
- 2.Rere.
- 3.Hekur.
- 4.Material rrethanor qe sherben per mbushje dhe sistemimin e shesheve.

Sigurimi i materialeve realizohet me transport per ne objekte.

9) INFORMACION PËR LIDHJET E MUNDSHME TË PROJEKTIT ME PROJEKTE TË TJERA EKZISTUESE PËRRETH/PRANË ZONËS SË PROJEKTIT.

Ky projekt nuk ka lidhje me projekte te tjera qe jane planifikuar te zbatohen ne kete zone.

10) INFORMACION PËR ALTERNATIVAT E MARRA NËKONSIDERATË, PËR SA I TAKON PËRZGJEDHJES SË VENDNDODHJES SË PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISË QË DO TË PËRDORET.

Opsioni i studiuar dhe i zgjedhur eshte pershkruar si me poshte :

Hec Marjan shfrytezon ujrata e perroit te Gures se Vesheve me kuote te niveli normal te ujit ne Vepren e Marrjes $\nabla N_{nor}^{B.S}=1463.15m$ dhe nivel per shkarkim te prurjes se plotes me 1% siguri rreth $\nabla_{shk}=1463.35m$. Ujrata e mbledhura nepermjet vepres se marrjes nivelngritese te pajisur galeri ujmarese, pasi dekantojne ne vepren kapese te zhavoreve dhe dekantus kalojne ne tubacionin e turbinave. Niveli i ujit ne dekantues+basenin e presionit perben edhe nivelin e bjefit te siperm per llogaritjen e renies statike $\nabla_{shk}=14632.70m$. Niveli i ujit ne bjefin e poshtem eshte llogaritur nga niveli i ujit ne aks te turbinave tek ndertesa e centralit qe eshte $\nabla N_{nor}^{B.P}=1313m$.

Sa me siper Renia bruto e Hec-it rezulton te jete $H_{bruto}=149.70m$. Renia neto ne baze te se ciles llogaritet fuqia e HEC-it percaktohet duke zbritur humbjet e sistemit me presion dhe ne basenin e presionit. Sistemi me presion konsiston ne tubacion me diameter $D=700mm$ dhe gjatesi $L=720m$. Humbjet totale gjatesore ne sistemin me presion jane $hw=2.30m$, si rezultat Renia neto do te jete $H_{neto}=149.70-2.30m=147.40m$

11) TË DHËNA PËR PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, TË ENERGISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE.

Sasia e lendes se pare (prurje uji) e matur eshte rreth $Q_{\text{log total}} = 0.57 \text{ m}^3/\text{s}$

12) AKTIVITETE TË TJERA QË MUND TË NEVOJITEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT, SI NDËRTIMI I KAMPEVE APO REZIDENCAVE ETJ.

Per zbatimin e projektit do ndertohen kampe me kontejner qe do jene kontejner shërbyese për objekte ndërtimore.

13) INFORMACION PËR LEJET, AUTORIZIMET DHE LICENCAT E NEVOJSHME PËR PROJEKTIN, NË PËRPUTHJE ME PËRCAKTIMET E BËRA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN / AUTORIZIMIN/ LICENCIMIN E PROJEKTIT.

1. Miratimi nga M.Mjedisit
2. Leje nga Ministria e Kultures
3. Leje nga Ministria e Turizmit
4. Leje nga Ministria e Energjise dhe Industrise

14) KOPJE TË LEJEVE, AUTORIZIMEVE DHE LICENCAVE QË DISPONON ZHVILLUESI PËR PROJEKTIN E PROPOZUAR, NË PËRPUTHJE ME PËRCAKTIMET E BËRA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN / AUTORIZIMIN/LICENCIMIN E PROJEKTIT.

Me poshte po japim licencat dhe miratimet qe ka mare HEC "MARJAN-GURA E VESHEVE"

- Miratimi nga Ministria e Energjise dhe Industrise.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIËS

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 49 të Ligjit nr. 43/2015 datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të VKM nr. 822, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni", i jepet
shoqërisë "MARITUDA" sh.p.k

MIRATIMI PARAPRAK


Nr. 11/16.04.2016

PËR VAZHDIM PROCEDURAVE
PËR NDËRTIMIN E BURIMIT TË RIJENËRUES TË PËRZEMTËSË/HIDROCENTRALIT
"MARJAN - GURË E VESHEVE" NË PËRROJIN GURË E VESHEVE BASHKË KORÇË-QARKU KORÇË

E drejta ekskluzive për të bërë majë ose studime të tjera, lidhur me investimet të mëdha të Hidrocentraleve
"MARJAN - GURË E VESHEVE"
Afati i vlefshmërisë së miratimit: 2 muaj

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI



Handwritten signature



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E KONCENSIONEVE, PROKURIMEVE, SHPRONËSIMEVE DHE
PRIVATIZIMIT

Nr. 116/ Prot.

Tiranë, më 24.6 2016

Drejtuar: Z.Gramos Selfo Muijollari, përfaqësues i shoqërisë "MARITUDA" sh.p.k.
Adresa: Rruga "Mikel Marubi", në katin e dytë përballë "2-Palmave", Kashar

TIRANË

Lënda: Mbi pranimin e aplikimit për ndërtimin e burimit të ri gjenerues, Hidrocentralit "MARJAN-GURA E VESHEVE"

Në përgjigje të aplikimit Tuaj, drejtuar Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, nëpërmjet të cilit shoqëria që ju përfaqësoni "MARITUDA" shpk, kërkon pajisjen me autorizim për ndërtimin e centralit elektrik, HEC "MARJAN - GURA E VESHEVE", me kapacitet prodhues 0.7 MW, në përronin Gura e Vesheve, Bashkia Korçë, Qarku Korçë, pas shqyrtimit të aplikimit dhe dokumenteve bashkëlidhur, Ju bëjmë me dije, sa më poshtë vijon:

Aplikimi Juaj "Për ndërtimin e kapacitetit të ri prodhues hidrocentralit "MARJAN - GURA E VESHEVE", është sipas formës së përcaktuar në aneksin 1 të rregullave të miratuara me VKM nr. 822 datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni" dhe është shoqëruar me dokumentat e parashikuara në nenet 6, 7, 8, 10 dhe 24 të këtyre rregullave.

Për sa më sipër, në zbatim të pikës 3 të nenit 12 të rregullave të miratuara me VKM të sipërcituar, Ju informojmë se aplikimi Juaj pranohet.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

KOLIBELE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E KONCENSIONEVE, PROKURIMEVE, SHPRONËSIMEVE DHE
PRIVATIZIMIT

Nr. 116/ Prot.

Tiranë, më 16/11/2016

Drejtuar: Z.Gramos Selfo Mujollari, përfaqësues i shoqërisë "MARITUDA" sh.p.k.
Adresa: Rruga "Mikel Marubi", në katin e dytë përballë "2-Palmave", Kashar

TIRANË

Lënda: Mbi dhënien e miratimit paraprak për vazhdimin e procedurave

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 49 të Ligjit nr. 43/2015 datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të VKM nr.822 datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni" si dhe:

referuar Raportit të Vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimit "Për dhënien e miratimit paraprak, për projektin e propozuar, për ndërtimin e objektit, hidrocentrali "MARJAN - GURA E VESHEVE" me kapacitet prodhues 0.7 MW, në përroin Gura e Vesheve, Bashkia Korçë, Qarku Korçë", bashkëlidhur gjeni Miratimin Paraprak Nr. 116/8 datë 16.11.2016 "Për vazhdimin e procedurave për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit "MARJAN - GURA E VESHEVE", në përroin Gura e Vesheve, Bashkia Korçë, Qarku Korçë", me afat të vlefshmërisë 12 muaj dhe të drejtë ekskluzive, për të bërë matje ose studime të tjera, lidhur me investimet për ndërtimin e këtij hidrocentrali.

Ju faleminderit për Bashkëpunimin.

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

KOLI BELE



Pergatitur nga :

"TAULANT" sh.p.k.
QKL, LN-7574-03-2014
Eksperte mjedisi:
Ditika Qatipi
Erjona Qatipi

Bashkepunim me, "EBS" sh.p.k.
Ing.Hidroteknik Fahri MAHO
Msc.Ing.Mjedisi Nelisa HAXHI

Investitor:

"MARITUDA" sh.p.k

